

Prot. 2211/217 K (e-k)

Datë, 22/11/2022, Tiranë

Lënda: *Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar*

Gjetjet nga monitorimi i KRIIK mbi aktivitetin dhe raportimin

financiar të fushatës zgjedhore të vitit 2021!

Përshëndetje,

Në zbatim të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 3.11.2022 për t'ua përcjellë gjetjet e Raportit të KRIIK-ut Partive Politike si dhe duke përjashtuar gjetjet që tashmë janë përfshirë në raportin e përgatitur nga KQZ-ja, ju ridërgojmë në formë të përmbledhur dhe të personalizuar se *lidhur me subjektin LZHK, KRIIK ka konstatuar se:*

- *raporti është dorëzuar në KQZ në tejkallim të afateve ligjore;*
- *mungon bilanci i aseteve dhe detyrimeve.*

Lidhur me dorëzimin e raportit të vetëdeklarimit në KQZ

LZHK ka dorëzuar raportin e vetëdeklarimit financiar në KQZ në datën 11 tetor 2021, në tejkallim të afatit ligjor.

Lidhur me bilancin e aseteve dhe detyrimeve

Sipas komunikimit shkresor me KQZ-në rezulton se LZHK nuk ka dorëzuar bilancin e aseteve dhe detyrimeve të partisë politike për periudhën nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve (pra nga data 6 shtator 2020 – 25 prill 2021), në zbatim dhe kuptim të detyrimit ligjor sipas nenit 92/3 “*Deklarimi dhe publikimi*” pika ç të Kodit Zgjedhor.

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi me ju,

Me konsideratë,

Për Koalicionin Për Reforma, Integrim

dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)

Premto Gogo

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania